



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 09.06.2020

24-06-2020
02/217

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I-rë (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS:

1. Ndarja e mjeteve financiare për luftim e pandemisë COVID-19, në territorin e Komunës së Malishevës.

Mbledhja mbahet me datë 30.03.2020 dhe filloi në ora 10:00 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 21 asambleistë, Kryetari i Komunës drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Të pranishëm jemi 21 asambleistë dhe të gjitha ata që mungojnë sigurisht që kanë një arsyeshmëri për shkak të situatës së pandemisë COVID-19. Me këtë rast dua t'i falemnderoj të gjitha institucionet që janë në ballë të detyrës edhe në këtë kohë pandemie siç janë: shëndetësia, policia, organet komunale, zjarrëfikësit dhe të gjithë ata që mundohen të luftojnë me këtë smundje!

Prej gjithësej 94 që janë të infektuar në nivel vendi 33 janë nga K. e Malishevës dhe kjo d.m.th që K.e Malishevës është ndër më e rrezikuara. Në mesin e tyre e kemi një anëtar të Kuvendit dhe një punëtor të Administratës. Urojmë që gjithë të prekurit nga ky grip që të shërohen sa më shpejt.

Të ndëruar anëtarë të Kuvendit po jua rikujtoj që 31 marsi ka qenë dita e fundit për deklarimin e pasurisë, mirëpo për shkak të kësaj pangemie është shty kjo datë.

Për t'na informuar më shumë rreth situatës së pandemisë në K. e Malishevës e ftoj Kryetarin!

Kryetari - Ragip Begaj: Të nderuar të pranishëm këtu dhe ju qytetarë të Malishevës, pershendetje! Për këtë gjendje e jashtëzakonshme që është në Malishevë këtë mbledhje e kemi thirrur në pajtim me Kryesuesin dhe grupet politike të këtij Kuvendi. Gjendja në Malishevë nuk është e mirë dhe jeni të njoftuar për çdo gjë rreth kësaj. Malishevë ka më shumë të infektuar në nivel vendi. Ne prej datës 12 e kemi formuar Shtabin Komunal dhe në çdo kohë jemi të aktivizuar dhe çdo herë kemi qenë në nivel detyre. Për t'i ballë kësaj situatë pandemie e kam bërë një kërkesë dhe ju e keni para vetës, ju jeni ata që vendosni.

I falemnderoj të gjithë donatorët që në këtë kohë na kanë ndihmuar sepse kam kritikuar nivelin qendror për mbështetjen e pakët që na kanë bërë në këtë kohë! Kërkoj nga niveli qendror që Malishevën ta kenë parasysh më shumë sepse sa do të zgjatë kjo periudhë nuk e dimë.

Po ju njoftoj për rastet veç e veç me data nëpër fshatra. Ka raste që familjet e izoluar kanë kërkuar furnizime të ndryshme ushqimore dhe na jemi kujdesur për ato familje. Cila është zgjidhja më e mirë për ta nuk e di, dhe sa do të zgjerohet numri i të infektuarve ne këtë nuk e dimë. Ne jemi para një situatë kur duhet të kemi kujdes të gjithë!

Rrahim Morina: Ju kërkoj falje që nuk kemi mundur që thirrjen e kësaj mbledhje ta bëjmë me material fizik edhe pse ne si Kuvend kemi qenë në ballë të detyrës! Ne për këtë mbledhje të jashtëzakonshme jemi takuar të dielën me shefat e grupeve dhe përveç të tjerave jemi dakorduar që debati të bëhet në nivel të shefave të grupeve për shkak të rrethane që janë krijuar nga ky grip. Sot është bërë dezinfektimi i sallës dhe salla i plotëson kushtet për mbajtjen e distancës. Sa i përket temës për të cilën e kemi thirrur mbledhjen e ftoj drejtorin e Drejtorisë së Financave që ta merr fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! U thanë të gjitha ato për qëllimin e thirrjes të kësaj mbledhje për sot dhe bashkarisht e kemi përgatitur një kërkesë për ndarjen e mjeteve financiare për të mbuluar disa shpenzime për ta tejkaluar këtë situatë. Këtë kërkesë e kemi ndarë në tri pjesë dhe detajet i keni në specifikacion që ju ka ardh me material:

1. Familjet që kanë nevojë për pako ushqimore dhe higjienike
2. Dezinfektimi i objektit të komunës, QKMF-në, QMF nëpër fshatra, objektin e zjarrëfikësve, objektin e policisë e institucione tjera dhe shtëpitë e familjarëve të prekur nga COVID-19 Çmimi për m² është 21 centë.
3. Furnizimi me mjete mbrojtëse për shëndetësi dhe stafi shtesë për 5 mjekë dhe 5 infermierë me kontrata për shërbime të veçanta

Ne kemi kërkuar edhe 10,000.00€ nga shuma e përgjithëshme edhe për aktivitetet tjera që ju i keni në material e që janë të paplanifikuara. Pra kërkesa totale është për 150,000.00€ e që merren nga kategoria e investimeve kapitale në mallëra dhe shërbime dhe një pjesë nga granti qeveritar dhe pjesa tjetër nga të hyrat vetanake. Duke u nisur nga ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 30 thotë që: deri në 5% organizata buxhetore mund pa miratim të ministrit të ndajë nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër buxhetore.

Rrahim Morina: Duke u nisur nga kjo situatë a shkojmë në nivel të shefave të grupit për debat? Kush është për?

Për: unanimisht

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Në këtë mbledhje të parë të jashtëzakonshme për këtë vit jemi thirrur për këtë virus që ka prekur gjithë globin e ndër të tjerët është edhe komuna jonë e

prekur me këtë virus. Deri me tani janë indetifikuar 33 qytetarë të komunës sonë me Covit-19 dhe ndër ta është edhe një anëtar i kësaj Asambleje. Ne në emër të grupit tonë politik ne të gjithë qytetarëve ju dëshirojmë shërim sa më të shpejtë. Për t'i bërë ballë këtë virusi ne me të gjitha grupet politike i kemi pasur 2 taktime paraprake dhe jam dakorduar për të ndarë një shumë për t'i dal në ndihmë K. së Malishevës për të gjithë qytetarët. Ne sigurisht që e përkrahim këtë kërkesë dhe ju bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë vendimet e Qeverisë dhe këshillat që vijnë nga institucionet shëndetsore për të ruajtur vetën, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi etj.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Pavarësisht që votuam që debati të zhvillohet në nivel të shefave, nëse dikush ka diçka për të diskutuar është mire që t'ia japim mundësinë.

Ne jemi në një situatë emergjente dhe pas disa takimeve me shefat e grupeve, Kryetarin, Kryesuesin dhe drejtorin e Drejtorisë së Financave kemi ardhur në përfundim që K. e Malishevës ka nevojë për një mbështetje shtesë financiare sa i përket shëndetësisë, për pako ushqimore, dezinfektim e çështje të tjera që të luftohet ky virus.

Ne si grup do ta përkrahim këtë kërkesë dhe pas marrjes së vendimit kërkoj nga Drejtoria e Financave dhe ajo e Drejtorisë që në fund të fundit të kësaj pandemie dhe të këtij virusi të sjellin një raport për këto shpenzime nga kjo ndarje buxhetore.

Kryetar, pas orës 15 qyteti është i lirë dhe është mirë që t'i thoni "Ekoregjonit" që ta bëjë dezinfektimin e rrugëve në qytet dhe mundësisht nëpër ato fshatra ku ka raste të gripit. Gjithashtu kërkoj që të bëhet dezinfektimi në hyrjet e banesave në Malishevë.

Një kontribut të madh janë duke e bërë edhe mediat dhe tek ndarja e mjeteve që ishte për Shtabin Emergjent është mirë që t'u ndahet një pjesë e buxhetit edhe mediave lokale siç janë dy televizionet në Malishevë.

Rrahim Morina: Si të doni, pavarësisht që u votua që debati të bëhet në nivel të shefave të grupeve nëse ju kërkon mund edhe të debatojnë ata që dëshirojnë.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ditë më parë unë parashtrova një kërkesë publike për Kryesuesin e Kuvendit e që besoj që është kërkesë e të gjithë kolegeve asambleistë pa ngjyrimet politike si për termentin në Shqipëri si tani për virusin Covid-19. Ja po ju lexoj edhe kërkesën time që ja kam parashtruar kërkesën z. Morina:

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Rrahim Morina.

Referuar gjendjes me të cilën po ballafaqohemi i'u adresohem me kërkesë që të bëni thirrje sa më shpejtë t'jetë e mundur lidhur me mbajtjen e një mbledhje të jashtëzakonshme online të Kuvendit Komunal në Malishevë ose të ndonjë formati tjetër gjithmonë në bazë të rregulloreve dhe rregullave, mirëpo të gjindet një metod për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme.

Rrjedhimisht, qëllimi i kësaj mbledhje të jetë miratimi i një shume mjeteve monetare në ndihmë për familjet skamnore me qëllim që sot më shumë se kurrë të kenë shëndetin para vështirësive të tyre për ushqime dhe medikamente të nevojshme mjeksore. Ju lutem, të kemi në konsideratë urgjencën përkatëse e të reflektohet humanizmi i nevojshëm karshi familjeve të tilla. Të jemi një dhe unik në raste të tilla e të reflektojmë duke i mbështetur këto kategori p.sh. iniciativë kjo më e realizuar në disa komuna të tjera .

Ju faleminderit me sinqeritetin dhe dëshirën që kjo kërkesë të gjejë përkrahjen dhe mbështetjen nga ana juaj dhe nga antarët e Kuvendit Komunal në Malishevë nga të gjitha subjektet politike që përfaqësojnë interesin e qytetarëve.

Ne grupi ynë e përkrahim plotësisht këtë kërkesë për ndarjen e mjeteve finaciare.

Rrahim Morina: Është e vertetë që Valoni ka bërë një thirrje të tillë ashtu edhe Ilazi për këtë situatë ka kërkuar takim përmes telefoni që më pas ne kemi organizuar takime të tilla.

Alban Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Këtij virusi që është përhapur në tërë globin nuk ka mundur t'i ikë as vendi ynë e më e prekura është K. e Malishevës e për luftimin e kësaj pandemie i falemnderoj mantelbardhët, Policinë e Kosovës, FSK-ën dhe të gjithë punojësit në sektorin publik dhe ata privatë! Nuk mund të mos e përmend suksesin e madh që ka treguar qeveria qendore dhe punën e ministrit të Shëndetësisë për menaxhimin e situatës dhe luftën që kanë bërë kundër virusit COVID-19.

Gjatë kësaj kohe janë shpërndarë shumë të pavërteta se çka ka bërë Ministria e Shëndetësisë për Malishevën e që Kryetari i Komunës në çdo vend e ka shpërndarë e mu më vjen keq që Kryetari nuk ka qenë në gjendje t'i kuptojë detyrat e veta që i përkasin e që komuna është përgjegjësi kryesor për qytetarët e saj. Jemi në një situatë emergjente dhe mos mundoheni që topin e përgjegjësisë ta hudsoni diku tjetër pavarësisht asaj që jeni duke dështuar në menaxhim.

Ne si kërkesë e përkrahim në parim këtë kërkesë sepse është iniciativë e anëtarëve të Kuvendit. Nuk ka lëvizë aspak Kryetari që të kërkojë ndihmën e Kuvendit për këtë çështje.

Ne nuk e kemi asnjë raport ashtu siç duhet prej kësaj qeverie që t'na tregojnë se çka kanë bërë deri më tani. Kryetar ty dhe menaxhmetit tënd duhet me t'i tregu detyrat dhe përgjegjësitë e reagimit kombëtar ja po t'i tregoj...

Kryetar po kërkoj edhe njëherë për fund:

- Bëjeni publike listën e furnizimeve që ju keni bërë si komunë, jo të donatorëve
- Lëshojë një numër telefoni në dispozicion ku qytetarët mund të thërresin për nevojat e ndryshme që përmenda edhe më heret
- Tregona neve planin e Shtabit Emergjent. A ka plan ky shtab, cilat janë parashikimet?
- Bëjeni publike të gjitha vendimet që ke marrë Kryetar në këtë kohë pandemie.
- Mos e përzini QKMF-në, lejeni drejtorin e QKMF-së që të bëjë punën e vet pa çështje politike e të merret me problemet shëndetësore që i takojnë.

Jam që të përkrahet kjo kërkesë në parim por duhet të diskutohet çështja e ndarjes së ndihmave sepse është duke shkuar katrahurë. Nuk duhet ta lejomë një gjë të tillë. Kërkoj 5 min pauzë që ne shëfat e grupeve të konsultohemi se si t'i qasemi këtij vendimi dhe a ka nevojë për ndonjë çështje tjetër shtesë.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Në emër të AAK-së i pershendes të gjitha ata persona që janë angazhuar e po angazhohen për mbrojtjen e qytetarëve nga kjo pandemi. Ne e përkrahim këtë kërkesë dhe ju falemnderojmë Kryetar për kontributin e dhënë në këtë kohë! Ne AAK-ja urojmë që të gjithë ata që janë të prekur me COVID-19 të shërohen sa më shpjet ashtu edhe kolegu ynë Demir Bajra!

Ne është mirë që këtë kohë të mos e shfrytëzojmë për poena politik, por të gjithë ta bëjmë së bashku të pamundrën që ta kalojmë këtë pandemi pa viktima e sa më lehtë të jetë e mundur!

Rrahim Morina: Mbasi debati në nivel të shefave të grupeve përfundoi, Alban Krasniqi propozoi që të marrim 5 min pauzë të diskutojmë në nivel të shefave të grupeve politike rreth çështjeve shtesë lidhur me këtë kërkesë. Kush është pro pauzës?

Për: 3

Kundër: 18

Abstenim: 0

Me këtë votim nuk kalon propozimi i Alban Krasniqit për pauzë.

Atëherë e hudhi në votim kërkesën e Kryetarit. Kush është pro që të miratohet kërkesa e Kryetarit për Ndarja e mjeteve financiare për luftim e pandemisë COVID-19, në territorin e Komunës së Malishevës?

Për: 20 (uanimisht)

Falemnderit për pjesëmarrje me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur duke ju uruar shërim sa më të shpejtë të gjithë atyre që janë të prekur me COVID-19!

Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina